

VENDIM
Nr. 133, datë 20.2.2013

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
TIRANË - ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Tiranë-Elbasan.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për objekte me vlerë 102 551 921 (njëqind e dy milionë e pesëqind e pesëdhjetë e një mijë e nëntëqind e njëzet e një) lekësh.

4. Shpenzimet procedurale në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 102 551 921 (njëqind e dy milionë e pesëqind e pesëdhjetë e një mijë e nëntëqind e njëzet e një) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2013 “Zëri i shpronësimeve”, miratuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

6. Shpronësimi të fillojë më 28.2.2013.

7. Për objektet për të cilat në kolonën përkatëse është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, pronarët të kompensohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të rifreskuar të pronësisë, që dorëzojnë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Për objektet për të cilat në kolonën përkatëse është bërë shënimi “Kualifikuar nga ALUIZNI”, poseduesit e këtyre objekteve të kompensohen, për efekt shpronësimi, nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, në bazë të vendimit nr. 563, datë 3.8.2011 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

9. Për objektet për të cilat në kolonën përkatëse është bërë shënimi “Proces regjistrimi”, pronarët përkatës të kompensohen, për efekt shpronësimi, pas përfundimit të këtij procesi, fakt, i cili do të konfirmohet zyrtarisht nga ZVRPP-ja, si dhe në bazë të dokumentacionit të pronësisë që dorëzojnë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

10. Autoriteti Rrugor Shqiptar të bëjë likuidimet e pronarëve, në bazë të pikave 7, 8 dhe 9 të këtij vendimi.

11. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Tiranë dhe Elbasan, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

12. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Tiranë dhe Elbasan, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen: procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

13. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit

të pasurive të paluajtshme, Tiranë dhe Elbasan, për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha